



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 87

24 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8179 datë 17.5.2013	Për emërim gjyqtari.....	3679
Dekret nr. 8180 datë 17.5.2013	Për emërim gjyqtari.....	3679
Dekret nr. 8181 datë 17.5.2013	Për emërim gjyqtari.....	3680
Vendim i KM nr. 397, datë 8.5.2013	Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të një sipërfaqeje trualli Kishës Katolike Shqiptare.....	3680
Vendim i KM nr. 398, datë 8.5.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi, asfaltimi, ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi rrugor i bllokut nr. 4, në qytetin e Fushë-Krujës, në bashkinë e Fushë-Krujës të qarkut të Durrësit.....	3683
Vendim i KM nr. 400, datë 8.5.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 308, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë)”.....	3684
Vendim i KM nr. 403, datë 8.5.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Himarë-Potam.....	3685
Vendim i KM nr. 404, datë 8.5.2013	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	3686

Vendim i KM nr. 406, datë 2.5.2013	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional e të sekretariatit teknik.....	3687
Vendim i KM nr. 408, datë 8.5.2013	Për dëshmshpërblimin për kafshët e eliminuara.....	3688
Vendim i KM nr. 410, datë 18.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 48, datë 23.1.2013 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT), të ndryshuar.....	3691
Udhëzim i KM nr. 1, datë 8.5.2013	Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2013.....	3691
Urdhër i MD nr. 191, datë 8.5.2013	Për një ndryshim në urdhrin nr. 8046, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, të ndryshuar.....	3697
Urdhër i MPPT nr. 70, datë 13.5.2013	Për miratimin e rregullores për përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e lundrimit ajror.....	3697
Vendim i ERE nr. 41, datë 29.4.2013	Mbi transferimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te “Kurum International” sh.a.....	3714
Vendim i ERE nr. 42, datë 29.4.2013	Mbi transferimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2” sh.a., nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te “Kurum International” sh.a.....	3714
Vendim i ERE nr. 43, datë 30.4.2013	Mbi ndryshimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e energjisë së rinovueshme.....	3715

DEKRET
Nr. 8179, datë 17.5.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Marina Raboshta, emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8180, datë 17.5.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Fjoralba Prifti, emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8181, datë 17.5.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Selim Kryeziu, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 397, datë 8.5.2013

PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI
KISHËS KATOLIKE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 4 shkronja “a” të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kishës Katolike Shqiptare t’i kalohet në pronësi, pa shpërblim, prona truall me nr. pasurie 186/59, 186/60, 186/12 dhe 186/13, në zonën kadastrale nr. 3981, fshati Sheq i Madh, Fier, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.


2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHESHI I NDERTIMIT DHE PLANI I VENDOSJES SE OBJEKTIT
AMBJENTE SPORTIVE (NE KOMPLEKSIN SHKOLLOR, SPORTIV E KULTUROR - FIER
ME INVESTITOR "KOMUNITETIN XHUZEPIN" TE KISHES KATOLIKE NE SHQIPERI.

STUDIMI URBANISTIK I KOMPLEKSIT SHKOLLOR, SPORTIV
E KULTUROR SHZ 1:2000





VENDIM
Nr. 398, datë 8.5.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIMI, ASFALTIMI, NDËRTIMI I TROTUAREVE DHE NDRIÇIMI RRUGOR I BLOKUT NR. 4, NË QYTETIN E FUSHË-KRUJËS, NË BASHKINË E FUSHË-KRUJËS TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi, asfaltimi, ndërtimi i trotuarëve dhe ndriçimi rrugor i bllokut nr. 4, në qytetin e Fushë-Krujës, në bashkinë e Fushë-Krujës të qarkut të Durrësit.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 24 (njëzet e katër) m² objekt, pronë private që shpronësohet, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 518 400 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga buxheti i bashkisë së Fushë-Krujës.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Fushë-Krujës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Fushë-Krujës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Fushë-Krujës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 24 (njëzet e katër) m² objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Fushë-Krujës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen bashkia e Fushë-Krujës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR “SISTEMIM-ASFALTIM, NDËRTIM TROTUARESH DHE NDRIÇIMIN RRUGOR TË BLOKUT NR. 4, NË QYTETIN E FUSHË-KRUJËS” NË BASHKINË E FUSHË-KRUJËS, QARKU DURRËS

Nr.	Emrat e pronarëve	Sip. e objektit m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e objektit	Nr. i pasurisë	Zona e kadastrave	Dok. i pronësisë
1	Vangjel Sali Zeneli	24	21600	518400	1/269	1664	Vërt.pronësie
	TOTALI	24		518400			



VENDIM
Nr. 400, datë 8.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 308, DATË 5.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
RRUGËS PARALELE TIRANË-VORË (KRAHU I MAJTË)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr. 308, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Sipërfaqja tokë arë, nga “16 437 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) m²” bëhet “15 473 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) m²”.

b) Vlera e tokës arë, nga “6 670 863 (gjashtë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë” bëhet “6 290 083 (gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë”;

c) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga “78 413 914 (shtatëdhjetë e tetë milionë e katërqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) lekë” bëhet “78 033 134 (shtatëdhjetë e tetë milionë e tridhjetë e tri mijë e njëqind e tridhjetë e katër) lekë”.

2. Në numrin rendor 30 të listës bashkëlidhur vendimit, ku pasqyrohen sipërfaqet që shpronësohen, bëhen ndryshimet sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të rifreskuar të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Autoriteti Rrugor Shqiptar të bëjë likuidimin sipas pikës 3 të këtij vendimi.

5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen: procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËVE PARALELE
TIRANË-VORË (KRAHU I MAJTË)

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pas.	Tokë arë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi/m ²	Vlera lekë	
1	Besim		Elshani	2119	95/10	250	395	98750	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		TOTALI				250		98750	

VENDIM
Nr. 403, datë 8.5.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR HIMARË-POTAM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Himarë-Potam”.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë truall 33 (tridhjetë e tre) m², me vlerë 105 600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë, si dhe për objekt me vlerë 562 387 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 667 987 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë, të përballohen nga Autoritetit Rrugor Shqiptar.
5. Vlera totale e shpronësimit, prej 667 987 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, zëri “Investime”.
6. Shpronësimi të fillojë më 10.5.2013.
7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja, sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor”, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzohet pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Autoritetit Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarit për të cilin është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja, sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor”, pasi të përfundojë procesi i regjistrimit, fakt, i cili do të konfirmohet nga ZVRPP-ja, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzohet nga pronari.



9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA (SHITESË) EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR "HIMARË E VJETËR-POTAM"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kad.	Nr. vërt. hip.	Lloji i pasurisë						Shënime
						Truall			Objekte		Vlera totale lekë	
						Sip. m²	Çmimi lekë m²	Vlera (lekë)	Lloji	Vlera (lekë)		
1	Fotaq	Llambro	Bollano	1952	232	33	3200	105600	banesë	562387	667987	Vërt. hipotekor, konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI							105600		562387	667987	

VENDIM
Nr. 404, datë 8.5.2013

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Dashnor Bajaziti, Zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Salih Tagani emërohet Zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 406, datë 2.5.2013

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL E TË SEKRETARIATIT
TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 21 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, si organ këshillimor në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është i përbërë nga 10 (dhjetë) anëtarë:

- a) Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, bashkëkryetar;
- b) Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bashkëkryetar;
- c) Një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë;
- d) Katër anëtarë, përfaqësues të punëdhënësve;
- dh) Dy anëtarë, përfaqësues të punëmarrësve.

2. Përcaktimi i anëtarëve të Këshillit, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, kryhet nga institucionet përgjegjëse që marrin pjesë në këtë Këshill, me kërkesën e përbashkët të Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Këshilli bashkëkryesohet me sistem rotacioni nga Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe bashkëkryetarët e Këshillit:

- a) thërrasin mbledhjet dhe i drejtojnë ato;
- b) caktojnë rendin e ditës, drejtojnë diskutimet, bashkërendojnë punën, sigurojnë zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta;
- c) marrin në konsideratë vendimet e marra përgjatë mbledhjeve të Këshillit dhe orientimet programore, kur ato janë marrë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, pavarësisht nga vlerësimi i tyre individual.

4. Këshilli funksionon si më poshtë vijon:

- a) Këshilli mbledhet mbi bazën e një kalendari, por jo më pak se një herë në katër muaj;
- b) Bashkëkryetarët vendosin për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe;
- c) Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime;
- d) Mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit.

5. Këshilli formulon mendime dhe propozime lidhur me:

- a) hartimin e strategjive dhe programeve kombëtare për arsimin dhe formimin profesional, drejtimit e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve nënligjore;
- b) përmirësimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional në përputhje me zhvillimet e sektorëve të ekonomisë dhe interesat e tregut të punës;



- c) projektbuxhetin e parashikuar për AFP-në dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
 - ç) standardet për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional;
 - d) zhvillimin e politikave dhe të programeve të veçanta, të kërkuara nga ministrat përgjegjës dhe rrugët e financimit të tyre;
 - dh) informimin e palëve për zhvillimet aktuale dhe perspektive të sistemit të AFP-së;
 - e) politikat dhe strategjitë e zhvillimit të sistemit të AFP-së;
 - ë) projektligjet dhe projektvendimet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tij;
 - f) propozimin e grupeve të përkohshme të punës për çështje të caktuara të zhvillimit të AFP-së;
 - g) anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të institucioneve të AFP-së.
6. Funksionimi i Këshillit mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga dy punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).
7. Sekretariati teknik bashkërendon veprimtarinë e Këshillit dhe kryen këto detyra:
- a) Organizon mbledhjet e Këshillit dhe krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre;
 - b) përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e Këshillit në formën e kërkuar për ekzekutim;
 - c) komunikon me kryetarin e radhës dhe me anëtarët e Këshillit në lidhje me rendin e ditës/datën, orën dhe vendin e mbledhjes së Këshillit;
 - ç) shpërndan dokumentacionin e mbledhjes dhe informacione të tjera të anëtarëve të Këshillit;
 - d) mban procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit;
 - dh) arkivon dokumentacionin e mbledhjeve të Këshillit;
 - e) lehtëson funksionimin e grupeve të përkohshme të ngritura nga Këshilli.
8. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës hapet një faqe e veçantë për veprimtarinë e Këshillit, për të cilin vepohet, si më poshtë vijon:
- a) Sekretariati teknik i KKAFFPK-së merr masat për hapjen e një lidhjeje të veçantë në faqen zyrtare në internet të ministrave për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të AFP-së;
 - b) Ky sekretariat përgatit dhe publikon, në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, të gjitha informacionet që mund të bëhen publike;
 - c) Para publikimit merret miratimi i bashkëkryetarëve të Këshillit.
9. Ngarkohen dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 408, datë 8.5.2013

PËR DËMSHPËRBLIMIN PËR KAFSHËT E ELIMINUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pronarët e kafshëve, të cilat janë eliminuar, në zbatim të vendimit të marrë nga autoriteti kompetent, ose për të cilat është provuar që kanë ngordhur pas zbatimit të masave të parashikuara në programin shtetëror të profilaksisë veterinarë, dëmshpërblehen në masën e vlerës së dëmit, sipas pikës 13 të këtij vendimi.

2. Janë subjekt dëmshpërblimi sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm pronarët e kafshëve, të cilat:

a) janë eliminuar për arsye se kanë rezultuar pozitiv për sëmundje infektive gjatë gjurmimeve diagnostikuese të ushtruara nga shërbimi veterinar rajonal, në zbatim të programit shtetëror të masave profilaktike veterinarë, pas testimeve në terren dhe në bazë të rezultateve të analizave të kryera në laboratorët e autorizuar ose në laboratorët e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë;

b) kanë ngordhur si pasojë e zbatimit nga shërbimi veterinar rajonal i masave të programit shtetëror të profilaksisë veterinarë;

c) kanë ngordhur si pasojë e një sëmundjeje, kontrolli i së cilës mbështetet financiarisht nga shteti, sipas listës së sëmundjeve, të miratuar me urdhër të ministrit.

3. Eliminimi dhe gruposja e kafshëve që përfshihen në rastet e shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij vendimi, për qëllimet e marrjes së dëmshpërblimit, kryhet në prani të komisionit të përhershëm të ngritur me urdhër të titullarit të drejtorisë rajonale të bujqësisë në qark (DRB).

4. Komisioni i ngritur sipas pikës 3 të këtij vendimi, kryesohet nga përgjegjësi i shërbimit veterinar në DRB dhe përbëhet nga veterinar i zyrtar i territorit ku eliminohet kafsha, veterinar i privat që ushtron veprimtarinë në territorin në fjalë, përfaqësuesi i zyrës së financës në DRB dhe një përfaqësues i shërbimit veterinar të njësisë së qeverisjes vendore. Në rastin kur shkatërrohen koshere të bletëve, shtohet dhe një përfaqësues nga një shoqatë e bletërritësve.

5. Komisioni harton procesverbalin e eliminimit të kafshës, në prani të pronarit të kafshës së eliminuar. Procesverbali firmoset dhe vulloset në vend nga anëtarët e komisionit dhe nga pronari i kafshës.

6. Procesverbali përgatitet në tri kopje të njëjta origjinale, nga të cilat njëra i lihet pronarit të kafshës së eliminuar, njëra mbahet në shërbimin veterinar të DRB-së dhe tjetra qëndron në shërbimin veterinar të qeverisjes vendore. Modeli i procesverbalit të vlerësimit të kafshës përgatitet nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në ministri dhe miratohet me urdhër të ministrit.

7. Eliminimi ose gruposja e kafshëve bëhet:

a) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për kafshët e rezultuara të infektuara gjatë kontrollit të tyre për brucelozë;

b) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për kafshët e rezultuara të infektuara gjatë kontrollit të tyre për tuberkuloz;

c) menjëherë pas konfirmimit zyrtar, në rastin e sëmundjes së tërbimit;

ç) menjëherë, në rastin kur dyshohet dhe është raportuar zyrtarisht nga pronari i kafshës te veterinar i zyrtar se ngordhja është shkaktuar nga sëmundja e plasjes.

8. Procedura për dhënien e dëmshpërblimit për kafshët e eliminuara dhe të gruposura, të cilat përmbushin kriteret e pikave 2 e 3, fillon me kërkesën e pronarit të kafshës, e cila paraqitet pranë DRB-së brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga eliminimi dhe gruposja e kafshës, e shoqëruar me kopje të dokumentacionit përkatës, si më poshtë vijon:

a) pasaportën e kafshës që eliminohet dhe matrikullin individual të saj;

b) procesverbalin e eliminimit dhe gruposjes, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi;

c) deklaratën noteriale që kafshët nuk janë të siguruara;

ç) dokumentin që provon shitjen e produktit dhe çmimin, në rastet sipas pikës 13;

d) sipas rastit, dokumentet veterinarë për zbatimin e masave sanitaro-veterinarë në fermë,



sipas masave të urdhëruara nga shërbimi veterinar i DRB-së, në bazë të të cilave është vendosur eliminimi dhe groposja e kafshës.

9. Titullari i DRB-së së qarkut, pas marrjes së kërkesës dhe dokumentacionit të kërkuar nga pronari i kafshës, ngre komisionin e vlerësimit të vlerës së kafshës së eliminuar dhe groposur, për të cilën do të bëhet dëmshpërblimi.

10. Komisioni i ngritur kryesohet nga përgjegjësi i shërbimit veterinar në DRB dhe përbëhet nga specialisti i sektorit të financës, veterinar i zyrtar i zonës ku dëmshpërblehet kafsha dhe zootekniku i DRB-së.

11. Komisioni vlerëson rregullsinë e kërkesës e të dokumentacionit përkatës dhe mban procesverbalin e miratimit të dëmshpërblimit në vlerën e caktuar. Procesverbali firmoset dhe vuloset në vend nga anëtarët e komisionit. Tipi i modelit të procesverbalit të dëmshpërblimit përgatitet nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në ministri dhe miratohet me urdhër të ministrit.

12. Procesverbali përgatitet në dy kopje të njëjta origjinale, nga të cilat njëra i dorëzohet pronarit të kafshës që dëmshpërblehet, tjetra mbahet në shërbimin veterinar të DRB-së.

13. Vlera e dëmshpërblimit për kafshën, e miratuar nga komisioni, do të përcaktohet nga vlera mesatare e tregut për llojin e kafshës në rajonin përkatës, gjatë muajit paraardhës, të përlogaritur nga sektori i statistikës në ministri. Për rastet kur produktet e marra nga therja e kafshës së eliminuar, për shkak të kushteve të përmendura në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij vendimi, mund të shiten, vlera e produktit të shitur do t’i zbritet vlerës së pagesës së dëmshpërblimit të përcaktuar sipas pikës 11 të këtij vendimi.

14. Titullari i DRB-së nxjerr aktin për dëmshpërblimin e pronarit të kafshës, i cili duhet të zbatohet nga DRB-ja brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dalja e aktit të dëmshpërblimit.

15. Nuk dëmshpërblehen pronarët e kafshëve për të cilat nuk paraqitet dokumentacioni sipas pikës 8 të këtij vendimi.

16. Nuk përfitojnë dëmshpërblimin, sipas këtij vendimi, të gjithë pronarët e kafshëve në rastet kur:

a) nuk kanë vënë në dispozicion kafshët e tyre për identifikimin dhe zbatimin e programit shtetëror të masave profilaktike veterinare;

b) nuk kanë njoftuar menjëherë për shfaqjen e sëmundjes infektive;

c) nuk kanë zbatuar masat e përcaktuara nga veterinar i zyrtar për dyshimin ose konfirmimin e sëmundjes;

ç) sëmundja në kafshë shfaqet gjatë importit ose gjatë karantinës së kafshëve të importuara dhe kur pronari është vetë fajtor për shpërthimin e sëmundjes, duke blerë kafshë të sëmura ose të dyshimta, të pashoqëruara me certifikatë veterinare;

d) sëmundja në kafshë shfaqet pasi ato janë ushqyer në zona të ndaluara;

dh) kanë shkelur kërkesat mjekësore veterinare për mbarështimin e kafshëve;

e) nuk është kryer eliminimi i kafshëve në afatet e përcaktuara sipas pikës 7 të këtij vendimi.

17. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 410, datë 18.4.2013

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 48, DATË 23.1.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË (UMT), TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 12/1 e 41 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të kreut V “Organika dhe financimi”, të vendimit nr. 48, datë 23.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Personeli i kualifikuar i qendrave spitalore universitare bëhet pjesë e organikës së personelit akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas njësive kryesore dhe atyre bazë. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar janë:

a) Rezultate të shkëlqyera (notë mesatare mbi 9) në studimet universitare, në studimet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë dhe titulli “Doktor”, për kandidatët që i kanë kryer këto studime brenda vendit, ose rezultate të mira (notë mesatare mbi 8) në studimet universitare të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë dhe titulli “Doktor”, për kandidatët që i kanë kryer këto studime jashtë vendit;

b) së paku 7 vite punë në qendra spitalore universitare apo në spital, pas përfundimit të specializimit.

Përkatësia në njësitë kryesore dhe ato bazë të UMT-së përcaktohet me vendim të Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit të Universitetit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 1, datë 8.5.2013

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave



UDHËZON:

1. Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë Republike, për vitin 2013, e cila të jetë 37 806 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2013, të jetë sipas tabelave nr. 1, nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e kostos mesatare të ndërtimit, të merren vlerat e kostos së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t'iu referuar zonave të afërta.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr. 1
KOSTO MESATARE E NDËRTIMIT

Në koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. Rrjetit inxhinierik
2. Projektit
3. Studimit gjeologjik dhe sizmik
4. Lejes së ndërtimit
5. Truallit
6. Shpenzime operationale të EKB 4%

NR	QYTETI	Kosto mesatare (aritmetike)	
		Sip. shfrytëzimi	Sip. ndërtimi
1	ELBASAN	37.441	30.896
2	GRAMSH	37.441	30.896
3	LIBRAZHD	37.441	30.896
4	PRRENJAS	37.441	30.896
5	PEOIN	37.713	31.118
6	POGRADEDEC	38.663	31.910
7	KORÇË	38.663	31.910
8	ERSEKË	38.663	31.910
9	TIRANË	36.408	30.050
10	DURRËS	36.203	29.887
11	KAVAJË	36.203	29.887
12	LUSHNJE	34.944	28.828
13	FIER	36.233	29.911
14	VLORE	38.256	31.588
15	BERAT	37.441	30.900
16	KUCOVË	37.441	30.900
17	SKRAPAR	37.441	30.900
18	PËRMET	37.753	31.149
19	TEPELENË	37.753	31.149
20	GJIROKASTËR	38.135	31.460
21	SARANDE	38.135	31.460
22	KRUJË	38.333	31.645
23	LAC	38.115	31.463
24	LEZHË	38.115	31.463
25	RRËSHEN	38.272	31.593
26	SHKODËR	37.433	30.889
27	PUKË	39.533	32.639
28	KUKËS	39.320	32.457
29	TROPOJË	39.320	32.457
30	MAT	38.865	32.079
31	PESHKOPI	38.865	32.079
	KOSTO MESATARE	37,806	31,202



Tabela nr. 2
VLERAT MESATARE TË SHIT-BLERJEVE
TË BANESAVE NË
TREGUN E LIRË PËR VITIN 2013, SIPAS
QYTETEVE

NR	Qytetet	lekë/ m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1. Oarku Tiranë		
1	Tiranë	
2	Vorë	
3	Kamëz	
4	Kavajë	
5	Rrogozhinë	
2. Oarku Durrës		
6	Durrës	
7	Krujë	
8	Shijak	
9	Sukth	
10	Fushë-Krujë	
3. Oarku Shkodër		
11	Shkodër	
12	Pukë	
13	Vau Dejës	
14	Koplik	
15	Fushë -	
4. Oarku Vlorë		
16	Vlorë	
17	Orikum	
18	Selenicë	
19	Himarë	
20	Sarandë	
21	Delvinë	
22	Konispol	
5. Oarku Korçë		
23	Korçë	
24	Pogradec	
25	Bilisht	
26	Ersekë	
27	Maliq	
28	Leskovik	
6. Oarku Fier		
29	Fier	
30	Lushnjë	
31	Ballsh	
32	Patos	
33	Divjakë	
34	Roskovec	
7. Oarku Berat		
35	Berat	
36	Kuçovë	

37	Polican	
38	Corovodë	
39	Ura -	
8. Oarku Elbasan		
40	Elbasan	
41	Librazhd	
42	Cërrik	
43	Gramsh	
44	Peqin	
45	Prrenjas	
46	Belsh	
9. Oarku Gjirokastrë		
47	Gjirokastrë	
48	Përmet	
49	Tepelenë	
50	Memaliaj	
51	Këlcyrë	
52	Libohovë	
10. Oarku Lezhë		
53	Lezhë	
54	Lac	
55	Mamurras	
56	Rrëshen	
57	Rubik	
11. Oarku Kukës		
58	Kukës	
59	Bajram	
60	Krumë	
12. Oarku Dibër		
61	Peshkopi	
62	Burrel	
63	Bulqizë	
64	Klos	
Komunat		
65	Komuna	
66	Komuna	
67	Komuna	
68	Komuna	
69	Komuna	
70	Komuna	



Tabela nr. 3
TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË
APARTAMENTEVE
NË QYTETIN E TIRANËS PËR VITIN
2013

Nr	Zonat	Lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi
1	1/1	98,200
2	1/2	70,500
3	2/1	193,000
4	2/2	137,600
5	2/3	115,200
6	2/4	118,500
7	2/5	90,750
8	3/1	81,500
9	3/2	67,800
10	4/1	76,500
11	4/2	62,000
12	5/1	191,000
13	5/2	133,500
14	5/3	116,500
15	5/4	94,500
16	6	71,000
17	7/1	125,300
18	7/2	121,000
19	7/3	93,500
20	7/4	71,500
21	8/1	112,800
22	8/2	95,800
23	8/3	71,500
24	9/1	136,200
25	9/2	107,000
26	9/3	72,600
27	10/1	146,300
28	10/2	143,800
29	10/3	111,800
30	11/1	88,500
31	11/2	72,800
32	11/3	63,000

URDHËR
Nr. 191, datë 8.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 8046, DATË 2.12.2004 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR KUSHTET MINIMALE QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË ZYRË NOTERIALE PËR TË MUNDËSUAR USHTRIMIN NORMAL TË VEPRIMTARISË SË NOTERIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 12 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pika 4 e urdhrit nr. 8046, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Zyra e noterit duhet të jetë me sipërfaqe të mjaftueshme për të lejuar ushtrimin normal të veprimtarisë së tij, por në çdo rast jo më e vogël se 20 m², dhe të jetë e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin nga ndikimi i agjentëve atmosferikë (si lagështia, pluhuri, dielli etj.) dhe nga zjarri.”.

2. Ngarkohen noterët të plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 4, brenda datës 1.9.2013. Mospërmbyshja e këtij detyrimi përbën shkelje disiplinore dhe passjell fillimin e ecuresë disiplinore ndaj noterit.

3. Struktura përgjegjëse për veprimtarinë noteriale në Ministrinë e Drejtësisë, brenda datës 15.9.2013, ushtron kontrole në të gjitha zyrat noteriale dhe i paraqet raport kontrolli Ministrit të Drejtësisë për përmbyshjen nga noterët të detyrimit mbi plotësimin e kushteve të parashikuara në pikën 4.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr. 70, datë 13.5.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË PËRBASHKËT TË TARIFAVE PËR SHËRBIMET E LUNDRIMIT AJROR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 8821, datë 15.10.2001 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Eurocontrol-it, ligjit nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit” dhe në zbatim të neneve 85, 86, 87 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të RSH-së”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore për “Përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e lundrimit ajror”, sipas tekstit dhe shtojcave që i bashkëlidhen këtij urdhri.
 2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Subjekti dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton masat e nevojshme për ndërtimin e një skeme tarifash për shërbimet e lundrimit ajror e cila është në përputhje me Sistemin e Tarifave për Rrugët Ajrore të Eurokontrollit.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet tek shërbimet e lundrimit ajror të ofruara nga ofruesit e shërbimit të trafikut ajror të caktuar sipas Nenit 8 të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian” dhe nga ofruesit e shërbimeve meteorologjike për trafikun e përgjithshëm ajror brenda ICAO EUR dhe rajoneve AFI, ku Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC) është përgjegjës për shërbimet e lundrimit ajror.
3. Kjo rregullore do të aplikohet tek shërbimet e lundrimit ajror të ofruara në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e Republikës së Shqipërisë, brenda rajoneve të tjera të ICAO, me kusht që Autoriteti i Aviacionit Civil, nepermjet procedurave perkatase ligjore të marre masa për të informuar Komisionin Europian dhe Shtetet Anëtare të KE-së, edhe Partnerët e ZPAE-se.
4. Kjo rregullore mund të aplikohet për ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror, të cilët kanë marrë leje për të ofruar shërbime të lundrimit ajror pa certifikim, sipas Nenit 7(5) të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian”.
5. AAC mund të autorizojë të mos e aplikojë këtë Rregullore tek shërbimet e lundrimit ajror të ofruara tek aeroportet me më pak se 50 000 lëvizje ajrore komerciale në vit, pavarësisht peshës maksimale të ngritjes (take-off) dhe numrit të vendeve të pasagjerëve, lëvizje të numëruara si shumë e ngritjeve dhe uljeve dhe e llogaritur si një mesatare mbi tre vitet e mëparshme.
6. Autoriteti i Aviacionit Civil nepermjet procedurave perkatase ligjore do të marre masa për të informuar Komisionin Europian, , në mënyrë që Komisioni Europian publikojë periodikisht një listë të azhurnuar të aeroporteve që përjashtohen nga ky rregull.
Pa paragjykuar aplikimin e parimeve referuar në Nenin 14 dhe 15 të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian”, AAC mund të autorizojë të mos llogarisë tarifat e shërbimeve të terminalit siç përcaktohet në Nenin 11 të kësaj Rregulloreje dhe të mos vendosë tarifa njësi për shërbimet në terminal, siç referohet tek Neni 13 i kësaj Rregulloreje në lidhje me shërbimet e lundrimit ajror të ofruara tek aerodromet me më pak se 150 000 lëvizje ajrore komerciale në vit, pavarësisht peshës maksimale të ngritjes (take-off) dhe numrit të vendeve të pasagjerëve, lëvizje të numëruara si shumë e ngritjeve dhe uljeve dhe e llogaritur si një mesatare mbi tre vitet e mëparshme.
Përpara dhenies së këtij autorizimi, AAC duhet të kryejë një vlerësim se deri ku kushtet e vëna në Aneksin I të kësaj Rregulloreje që përfshijnë konsultimin me përfaqësuesit e përdoruesve të hapësirës ajrore janë plotësuar.

Vlerësimi përfundimtar nëse kushtet janë plotësuar dhe vendimi i AAC duhet të publikohen dhe komunikohen tek Komisionin , duke dhënë një arsyetim të plotë për konkluzionet e AAC, duke përfshirë rezultatet e konsultimit me përdoruesit.

Neni 2

Përkufizime

Në funksion të kësaj Rregulloreje, do të aplikohen përkufizimet e dhëna në Udhëzimin Nr.5, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi krijimin e strukturës rregullatore nën Një Qiell të Vetëm Evropian”.

Përveç atyre do të aplikohen edhe përkufizimet e mëposhtëme:

- (a) **“përdorues i shërbimeve të lundrimit ajror”** do të thotë operatori i avionit në kohën kur kryhet fluturimi ose nëse identiteti i operatorit është i panjohur, pronari i avionit, po të mos provojë që person tjetër ishte pronar në atë moment;
- (b) **“përdorues i hapësirës ajrore”** do të thotë çdo person ose ent legal që përfaqëson interesat e një ose disa kategorive përdoruesish të shërbimeve të lundrimit ajror;
- (c) **“IFR”** do të thotë Rregulla të Fluturimit me Instrument;
- (d) **“VFR”** do të thotë Rregulla të Fluturimit Vizual;
- (e) **“zonë e tarifimit e mbikalimeve (ne rrugë)”** do të thotë volumi i hapësirës ajrore për të cilën është vendosur një kosto e vetme bazë dhe një njësi e vetme pagese;
- (f) **“zonë e tarifave të terminalit”** do të thotë një aeroport ose grup aeroportesh për të cilën është vendosur një kosto e vetme bazë dhe një njësi e vetme pagese;
- (g) **“transport ajror tregetar”**, do të thotë do të thotë operacioni i çdo avioni që përfshin transportin e pasagjerëve, mallrave ose postës me shpërbim ose me qira;
- (h) **Marreveshja shumëpaleshe** nenkupton Marreveshjen për krijimin e Zonës së Perbashkët Europiane të Aviacionit, shtojcat dhe Protokollin I i saj, ratifikuar me Ligjin Nr.9658, datë 18.12.2006.

Neni 3

Parimet e skemës së tarifave

1. Skema e tarifave duhet të reflektojë kostot e shkaktuara ose direkt ose indirekt në ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror.
2. Kostot e shërbimeve për mbikalimet duhet të financohen me anë të tarifave të mbikalimit të vendosura mbi përdoruesit e shërbimeve të lundrimit ajror.
3. Kostot e shërbimeve në terminal duhet të financohen nga tarifat e shërbimeve në terminal të vendosura mbi përdoruesit e shërbimeve të lundrimit ajror dhe/ose burime të tjera të ardhurash, duke përfshirë subvencionet e tërthorta sipas ligjit në fuqi.
4. Paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni nuk duhet të paragjykojnë financimin e përjashtimeve të përdoruesve të veçantë të shërbimeve të lundrimit ajror përmes burimeve të tjera të financimit sipas Nenit 9 të kësaj Rregulloreje.
5. Skema e tarifave duhet të ofrojë transparencë dhe konsultim mbi bazat e kostos dhe mbi shpërndarjen e kostove midis shërbimeve të ndryshme



Neni 4

Përcaktimi i zonave të tarifuara

1. AAC angazhohet në përcaktimin e zonave të tarifuara në hapësirën ajrore që bien nën përgjegjësinë e shtetit shqiptar, ku shërbimet e lundrimit ajror u ofrohen përdoruesve të hapësirës ajrore.
2. Zonat e tarifuara duhet të përcaktohen në një mënyrë të qëndrueshme me operacionet dhe shërbimet e kontrollit të trafikut ajror, pas konsultimit me përfaqësuesit e përdoruesve të hapësirës ajrore.
3. Një tarifë për mbikalimet duhet të shtrihet që nga toka e deri, dhe duke përfshirë, hapësirën e sipërme ajrore, pa paragjykuar mundësinë që AAC të krijojë një zonë specifike për një zonë të terminalit komplekse, pas konsultimit me përfaqësuesit e përdoruesve të hapësirës ajrore.
4. Nëse zonat e tarifuara shtrihen përgjatë hapësirës ajrore të më shumë se një Shteti Anëtar të BE dhe Partnerët e ZPAE-se, Shteti tjetër i prekur do të marrë masat përkatëse për të garantuar qëndrueshmërinë dhe uniformitetin në aplikimin e kësaj Rregulloreje në hapësirën ajrore të prekur. Për këtë duhet njoftuar Komisioni Europian dhe Eurokontrolli.

KAPITULLI II

KOSTOT DISPOZITËS SË SHËRBIMIT TË LUNDRIMIT AJROR

Neni 5

Shërbime, pajisje dhe aktivitete të ligjshme

1. Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror referuar në Nenin 1(2) dhe (4) të kësaj Rregulloreje duhet të caktojnë kostot e shkaktuara në ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në lidhje me pajisjet dhe shërbimet e ofruara për dhe të implementuara nën Planin Rajonal të ICAO për Lundrimin Ajror, Rajonin Evropian, zonat e pagesës nën përgjegjësinë e tyre. Këto kosto duhet të përfshijnë shpenzimet administrative, trajnimet, studimet, testimet dhe eksperimentet si edhe kërkimet dhe zhvillimet e shpërndara tek këto shërbime.
2. Kostot e mëposhtme mund të përfshihen kur ato janë shkaktuar në sajë të ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror:
 - a. kostot e shkaktuara nga autoritetet kombëtare relevante;
 - b. kostot e shkaktuara nga organizatat e njohura, siç referohet në Nenin 3 të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian”;
 - c. kostot që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare
3. Pa paragjykuar burimet e tjera të financimit, dhe me synimin për një nivel të lartë sigurie, kosto eficiente dhe ofrim shërbimi, pagesat mund të përdoren për të siguruar financime për projekte të planifikuara për të ndihmuar kategori specifike përdoruesish të hapësirës ajrore dhe/ose ofruesat të shërbimit të lundrimit ajror për të përmirësuar infrastrukturën e përbashkët të lundrimit ajror, dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror dhe përdorimin e hapësirës ajrore në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 6

Llogaritja e kostove

1. Kostot e shërbimeve të pranueshme, pajisjeve dhe aktiviteteve brenda domethënies së Nenit 5 të kësaj Rregulloreje do të përcaktohen në një mënyrë të tillë që të jenë sipas llogarive të referuara në Nenin 12 të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian” 1 Janar deri në 31 Dhjetor. Sidoqoftë, efektet jo-periodike që rezultojnë nga futja e Standarteve Ndërkombëtare të Llogaritjes mund të shtrihen përtej një periudhe që nuk i kalon 15 vjet.

2. Kostot e referuara në paragrafin 1 mësipër duhet të ndahen në kosto të stafit, kosto të operimeve të tjera, kosto të zhvlerësimit, kostoja e kapitalit dhe elementeve të veçantë që përfshijnë tarifat e pa-rikuperueshme dhe tarifa doganore e paguar dhe të gjitha kostot e tjera.

Kostot e operimeve të tjera duhet të përfshijnë kostot që vijnë nga blerjet e mallrave dhe shërbimeve të përdorura për të ofruar shërbime të lundrimit ajror, në veçanti të shërbimeve të jashtme, të tilla si komunikimi, punonjës të jashtëm, të tillë si konsulentë, materiale, energji, shërbime komunale, qera godinash, pajisje dhe makineri, mirmbajtje, kosto siguracionesh dhe shpenzime udhëtimesh. Kur një ofrues shërbimi trafiku ajror blen shërbime të tjera lundrimi ajror, ofruesi duhet të përfshijë në kostot e operimeve të tjera shpenzimet aktuale për ato shërbime.

Kosto të zhvlerësimit duhet të ketë të bëjë me asetet totale të fiksuara në operim për qëllime të shërbimeve të lundrimi ajror. Asetet e fiksuara duhet të zhvlerësohen, sipas jetëgjatëgjatësisë së pritshme të operimit, duke përdorur metodën vijës së drejtë të aplikuar tek kostot historike të aseteve të zhvlerësuar. Kur asetet i përkasin ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror i cili i nënshtrohet një skeme stimuluese siç referohet në Nenin 12(2) të kësaj Rregulloreje, për llogaritjen e zhvlerësimit, në vend të llogaritjes së kostos historike mund të aplikohet llogaritja e kostos aktuale. Metoda do të mbetet konstante gjatë kohëzgjatjes së zhvlerësimit.

Kostoja e kapitalit do të jetë e barabartë me prodhimin e:

- (a) Shumës së vlerës mesatare neto të katalogut të asetit të fiksuar i përdorur ofruesi i shërbimeve të lundrimi ajror në operim ose nën ndërtim me vlerën mesatare neto të aseteve aktuale që kërkohen për dispozitën e shërbimeve të lundrimi ajror; dhe
- (b) Mesataren e vlerësuar të normës së interesit mbi debitë dhe akthimin në vlerë aseti.

Elementet e veçantë duhet të jenë kostot e pa-rikuperueshme në lidhje me dispozitën e shërbimeve të lundrimi ajror që kanë ndodhur gjatë vitit.

3. Në funksion të paragrafit 2, nënparagrafi i pestë më sipër, faktorët e vlerësimit duhen bazuar mbi proporcionin e financimit përmes debitit ose vlerës së asetit. Norma e interesit mbi debitë duhet të jetë e barabartë me normën mestare të interesit mbi debitë e ofruesit të shërbimit të lundrimi ajror. Kthimi në vlerë aseti duhet të marrë parasysh riskun financiar të ofruesit të shërbimit të lundrimi ajror duke u bazuar tek norma kombëtare e obligacionit. Kur ofruesi i shërbimit të lundrimi ajror i nënshtrohet një skeme stimuluese siç referohet tek Neni 12(2) të kësaj Rregulloreje, mund të shtohet një shpërblim shtesë për të garantuar konsideratë të mjaftueshme të rrezikut specifik financiar i supozuar nga ky ofrues.



Kur asetet nuk i përkasin ofruesit të shërbimit të lundrimi ajror, por janë të përfshira në përlllogaritjet e kostos së kapitalit, AAC duhet të sigurojë nepermjet mbikqyrjes që kostot e këtyre aseteve nuk merren dy herë.

Neni 7

Shpërndarje e kostove

1. Kostot e shërbimeve të pranueshme, pajisjeve dhe aktiviteteve brenda domethënies së Nenit 5 të kësaj Rregulloreje duhet të shpërndahen në një mënyrë transparente tek zonat e pagesave për të cilat ato aktualisht shkaktohen.
Kur kostot shkaktohen nëpër zona të ndryshme pagesash, ato duhet të shpërndahen në mënyrë proporcionale në bazë të një metodologjie transparente siç kërkohet në Nenin 8.
2. Kostoja e shërbimeve fundore duhet të lidhet me shërbimet e mëposhtëme:
 - (a) shërbimet e kontrollit të aerodromit, shërbimet e informacionit të fluturimit të aerodromit duke përfshirë shërbimet këshilluese të trafikut ajror dhe shërbimet e alarmit;
 - (b) shërbimet e trafikut ajror që lidhen me afrimin dhe nisjen e avionit brenda një distance të caktuar të një aeroporti në bazë të kërkesave operacionale;
 - (c) një shpërndarje e përshtatshme e të gjithë komponentëve të shërbimeve të lundrimi ajror, duke reflektuar një atribut të përpjestueshëm midis shërbimeve të mbikalimit dhe ato fundore.
3. Kostoja e shërbimeve të mbikalimit duhet të lidhet me kostot e referuara në paragrafin 1 për përjashtimin e kostove referuar në paragrafin 2 të këtij Neni.
4. Nëse përjshatimet janë dhënë për fluturimet VFR në përputhje me Nenin 9 të kësaj Rregulloreje, ofruesi i shërbimit të lundrimi ajror duhet të identifikojë kostot e shërbimeve të lundrimi ajror të ofruara për fluturimet VFR të ndara nga kostot e ofruara për fluturimet IFR. Këto kosto mund të vendosen nëpërmjet një metodologjie kostoje margjinale duke marrë në konsideratë përfitimet e fluturimeve IFR që burojnë prej shërbimeve të dhëna për fluturimet VFR.

Neni 8

Transparenca e kostos bazë

1. Pa ndryshuar Nenin 18 të Rregullores së dispozitës së shërbimit, AAC dhe/ose ANTA duhet të organizojë një shkëmbim informacioni mbi kostot bazë, investimet e planifikuara dhe trafikun e pritshëm me përfaqësues të përdoruesve të hapësirës ajrore nëse kërkohet më vonë kështu. Për pasojë, ata duhet të caktojnë kostot e tyre respektive në përputhje me Nenin 5 në një mënyrë transparente për përdoruesit e hapësirës ajrore, Komisionin dhe Eurokontrollin të paktën çdo vit.
2. Informacioni referuar paragrafit 1 mësipër duhet të bazohet mbi tabelat e raportimit dhe rregullat e detajuara në Shtojcën II të kësaj Rregulloreje ose kur AAC ka marrë vendim të referohet në Nenin 1(6) të kësaj Rregulloreje, ose ka treguar tek Komisioni që është konsideruar marrja e një vendimi të tillë, në Shtojcën III pjesa 1 kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI III

FINANCIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË LUNDRIMIT AJROR NËPËRMJET TARIFAVE TË LUNDRIMIT AJROR

Neni 9

Përfshirjet nga tarifat e lundrimit ajror

1. Përfshihen nga tarifat e mbikalimeve:
 - (a) fluturimet e kryera nga avioni i cili ka një peshë maksimale ngritjeje më pak se dy tone metrike;
 - (b) fluturimet e përziera VFR/IFR në zonat e tarifuara ku ato kryhen ekskluzivisht nën VFR dhe ku nuk është vënë një tarifë për fluturimet VFR;
 - (c) fluturimet e kryera ekskluzivisht për transport, me mision zyrtar, të një monarku ne fron (nese ka) dhe familjareve të tij të drejteperdrejte, të kreut të shtetit, kreut të qeverisë, ministrave të qeverisë; në të gjitha rastet, kjo duhet të vërtetohet me anë të indikatorit të statusit përkatës në planin e fluturimit;
 - (d) fluturimet e kërkim shpëtimit të autorizuar nga organet përkatëse kompetente.
2. AAC mund të përfshijë nga tarifat e mbikalimeve:
 - (a) fluturimet ushtarake të kryera nga avioni ushtarak i çdo shteti;
 - (b) fluturimet stërvitore të kryera ekskluzivisht për qëllim marrjeje licëse ose të një rangu në rastin e pilotëve, ku ky vërtetohet nga një shënim përkatës në planin e fluturimit; fluturimet duhet të kryhen vetëm brenda hapësirës ajrore të shtetit shqiptar; fluturimet nuk duhet të shërbejnë për transport pasagjerësh dhe/ose mallrash, as edhe për pozicionimin ose transportimin e avionit;
 - (c) fluturimet e kryera ekskluzivisht me qëllim kontrollin ose testimin e pajisjeve të përdorura ose të synuara për t'u përdorur si ndihmë në tokë për lundrimin ajror, duke përfshirë fluturimet e pozicionimit nga avioni në fjalë;
 - (d) fluturimet që përfundojnë tek aeroporti prej të cilit avioni është ngritur dhe gjatë të cilit nuk është bërë ulje e ndërmjetme;
 - (e) fluturimet VFR;
 - (f) fluturimet humanitare të autorizuar nga bordi përkatës kompetent;
 - (g) fluturimet doganore dhe policore.
3. AAC mund të përfshijë nga tarifat e terminalit, fluturimet e referuara tek paragrafi 1 dhe 2 më sipër.
4. Kostot e shkaktuara për fluturimet e përfshiuara nuk duhet të merren në konsideratë për llogaritjen e tarifave për njësi. Këto kosto duhet të përbëhen nga:
 - (a) kostot e fluturimeve të përfshiuara VFR të identifikuar në Nenin 7(4) të kësaj Rregulloreje; dhe
 - (b) kostot e fluturimeve të përfshiuara IFR, të cilat duhen llogaritur si prodhim i kostove të shkaktuara për fluturimet IFR me raportin e numrit të njësive të shërbimit të përfshiuar me numrin total të njësive të shërbimit; kostot e shkaktuara për fluturimet IFR duhet të jetë e barabartë me kostot totale pa kostot e fluturimeve VFR.



Neni 10

Llogaritja e tarifave për mbikalimet

1. Tarifa e mbikalimit për një fluturim specifik në një zonë specifike tarifimi mbikalimesh duhet të jetë e barabartë me prodhimin e normës njësi të vendosur për këtë zonë mbikalimi me njësitë e shërbimit të mbikalimit për këtë fluturim.
2. Pa ndryshuar implementimin nga AAC të një skeme stimuluese në lidhje me ofruesat e shërbimit të lundrimit ajror në përputhje me Nenin 12(2) të kësaj Rregulloreje, norma njësi në zonën e tarifimit të mbikalimit duhet të llogaritet duke pjesëtuar numrin e parashikuar të njësive të tarifueshme të shërbimit të mbikalimit për vitin përkatës me kostot e parashikuara për shërbimet elundrimit ajror. Kostot e parashikuara duhet të përfshijnë bilancin që rezulton prej mbulimit të sipërm ose të poshtëm të viteve të mëparshme.
3. Njësitë e shërbimeve të mbikalimit duhet të llogariten sipas Shtojcës IV të kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Llogaritja e tarifave për shërbimet fundore

1. Pa ndryshuar mundësinë, nën Nenin 13 të kësaj Rregulloreje, e financimit të shërbimeve fundore të lundrimit ajror nëpërmjet burimeve të tjera të finanim, tarifa e shërbimeve fundore për një fluturim specifik në një zonë specifike fundore tarifimi duhet të jetë e barabartë me prodhimin e normës njësi të vendosur për këtë zonë fundore tarifimi me njësitë e shërbimit fundor për këtë fluturim..
2. Pa ndryshuar implementimin nga AAC të një skeme stimuluese në lidhje me ofruesat e shërbimit të lundrimit ajror në përputhje me Nenin 12(2) të kësaj Rregulloreje, norma njësi në zonën fundore të tarifimit duhet të llogaritet duke pjesëtuar numrin e parashikuar të njësive të tarifueshme të shërbimit fundor për vitin përkatës me kostot e parashikuara për shërbimet elundrimit ajror. Kostot e parashikuara duhet të përfshijnë bilancin që rezulton prej mbulimit të sipërm ose të poshtëm të viteve të mëparshme.
3. Njësitë e shërbimeve të mbikalimit duhet të llogariten sipas Shtojcës IV.

Neni 12

Skemat stimuluese

1. AAC mund të ndërtojë ose aprovojë skema stimuluese që konsistojnë në avantazhe financiare ose disavantazhe të aplikuara mbi një bazë jo-diskriminuese dhe transparente për të mbështetur përmirësimet në dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror që rezultojnë në një llogaritje të ndryshme të tarifave të vendosura në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni. Këta stimuj mund të aplikohen tek ofruesat e shërbimeve të lundrimit ajror dhe/ose përdoruesit e hapësirës ajrore.
2. Kur AAC vendos të zbatojë një skemë stimuluese mbi ofruesat e shërbimeve të lundrimit ajror, ai duhet, pas konsultimit referuar Nenit 15 të kësaj Rregulloreje, të vendosë qysh më përpara kushtet për përcaktimin e nivelit maksimal të normës së njesisë ose burimeve të të ardhurave për secilin vit mbi një periudhë pa kaluar 5 vjet. Këto kushte duhet të

vendosen duke iu referuar nivelit të projektuar të kostove (duke përfshirë koston e kapitalit) mbi periudhën dhe gjithashtu mund të përcaktojë modulacione financiare (mbi ose nën koston së pritshme) bazuar mbi aspektet e veçanta të performancës së ofruesave të shërbimeve të lundrimit ajror të cilat mund të përfshijnë efikasitetin, cilësinë e shërbimit, performancën e projekteve të veçanta, momenteve historike ose kompetencave ose një nivel bashkëpunimi me ofrues të tjerë të shërbimeve të lundrimit ajror duke marrë në konsideratë efektet e rrjetit.

3. Kur AAC vendos të zbatojë një skemë stimuluese, duke përfshirë modulimet e orëve të natës, në lidhje me përdoruesit e shërbimeve të lundrimit ajror, ai duhet që, pas konsultimit referuar Nenit 15 të kësaj Rregulloreje, të rregullojë tarifat e shkaktuara nga ata në mënyrë që të pasqyrojë përpjekjet e bëra nga këta përdorues për të optimizuar përdorimin e shërbimeve të lundrimit ajror, për të ulur gjithë kostot e atyre shërbimeve dhe për të rritur efikasitetin e tyre, veçanërisht duke ulur tarifat sipas pajisjeve të avionit që rritin kapacitetin ose për kompensimin e papërshtatshmërisë në zgjedhjen e rrugëve më pak të ngjeshura.

Skema stimuluese do të jetë e kufizuar në kohë, fushëveprim dhe sasi. Kursimet e llogaritura të gjeneruara nga përmirësimet e efikasitetit operacional duhet të paktën të kompensojnë koston e stimuljeve brenda një afati kohor të arsyeshëm. Skema do të jetë subjekt i një shqyrtimi të rregullt që përfshin përfaqësues të përdoruesve të hapësirës ajrore.

4. AAC e cila ka ndërtuar ose miratuar skemat stimuluese do të monitorojë implementimin siç duhet të këtyre skemave stimuluese nga ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror.

Neni 13

Vendosja e tarifave njësi për zonat e tarifuara

1. AAC duhet të sigurojë që tarifat njësi janë vendosur për çdo zonë tarifimi mbi një bazë vjetore. Ai gjithashtu mund të sigurojë që tarifat njësi janë vendosur qysh më përpara për çdo vit për një periudhë që nuk e kalon 5 vjet.
2. Në rast të ndryshimeve madhore të papritura të trafikut apo kostove, tarifat njësi mund të amendohen gjatë rrjedhës së vitit.
3. AAC duhet të informojë Komisionin dhe Eurokontrollin, kur duhet, për vendosjen e tarifave njësi për çdo zonë tarifimi.

Neni 14

Mbledhja e tarifave

1. AAC mund të mbledhë tarifat nëpërmjet një tarife të vetme për fluturim.
2. Përdoruesit e shërbimeve të lundrimit ajror duhet me të paguajnë menjëherë dhe plotësisht të gjitha tarifat e shërbimeve të lundrimit ajror.
3. AAC duhet të sigurojë që të aplikohen masa detyruese efektive. Këto masa mund të përfshijnë refuzimin e shërbimeve, pengimin e avionit ose masa të tjera detyruese në përputhje me ligjin në fuqi.



Neni 15

Transparenca e mekanizmave të tarifimit

1. AAC duhet të sigurojë që përfaqësuesit e përdoruesve të hapësirës ajrore janë konsultuar mbi politikën e tarifave mbi një bazë të rregullt.
Si përfundim, ai duhet t'i sigurojë atyre informacionin e nevojshëm mbi mekanizmat e tij të tarifimit siç përcaktohen në Shtojcën VI të kësaj Rregulloreje, ose kur ai ka marrë vendimin për t'iu referuar Nenit 1(6) të kësaj Rregulloreje, informacionin e nevojshëm të përcaktuar në Shtojcën III, pjesa 2 të kësaj Rregulloreje, dhe duhet të organizojë një seancë dëgjimi efektive dhe transparente për të paraqitur këtë informacion si edhe informacionin që i referohet Nenit 8 të kësaj Rregulloreje, në prezencën e ofruesve të shërbimit të lundrimit ajror të përfshirë.
2. Pa ndryshuar Nenin 18 të Udhëzimit Nr. 6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT "Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian", dokumentacioni përkatës duhet të vendoset në dispozicion të përdoruesve të hapësirës ajrore, Komisionit, Eurokontrollit dhe autoritetit kombëtar mbikëqyrës tre javë përpara seancës degjimore.

KAPITULLI IV

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Apelimi

AAC duhet të sigurojë që vendimet e marra në vijim të kësaj Rregulloreje janë arsyetuar siç duhet dhe i janë nënshtruar një shqyrtimi efektiv dhe/ose proçedure apelimi.

Neni 17

Lehtësimi i monitorimit të përputhshmërisë

Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të marrin masa për të lehtësuar inspektimet dheurvejimet nga Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës ose nga një organizatë e njohur që vepron në interes të tij, duke përfshirë vizitat tek ofruesi.

Personat e autorizuar duhet të pajisen formalisht me autoritet:

- a. për të ekzaminuar dokumentat përkatëse financiare, regjistrat asetëve, inventaret dhe çdo material tjetër që ka lidhje me vendosjen e tarifave të lundrimit ajror;
- b. për të marrë kopje ose ekstrakte prej dokumentave të tilla;
- c. për të kërkuar shpjegime me gojë;
- d. për të hyrë në ndërtesat përkatëse, trojet apo mjetet e transportit.

Inspektime dheurvejime të tilla duhet të kryhen në përputhje me proçedurat në fuqi aty ku ato janë ndërmarë.

SHTOJCA I

**VLERËSIMI I KUSHTEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR
TEK AEROPORTET QË BIEN NËN NENIN 1(6)**

Kushtet që vlerësohen nën Nenin 1(6) të kësaj Rregulloreje janë si më poshtë:

1. Shtrirja tek e cila ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror mund të ofrojnë lirshëm ose të tërhiqen prej dispozitës së shërbimit të lundrimit ajror tek aeroportet:
 - ekzistenca e ndonjë pengese të rëndësishme ekonomike që do të pengonte një ofrues të shërbimit të lundrimit ajror nga ofrimi ose tërheqja për të ofruar dispozitën e shërbimit të lundrimit ajror,
 - ekzistenca e ndonjë pengese të rëndësishme ligjore që do të pengonte një ofrues të shërbimit të lundrimit ajror nga ofrimi ose tërheqja për të ofruar dispozitën e shërbimit të lundrimit ajror,
 - gjatësia e kohëzgjatjes së kontratës,
 - ekzistenca e një procedure që lejon asetet dhe stafin të transferohet prej një ofruesi shërbimi të lundrimit ajror në një tjetër.
2. Shtrirja tek e cila aeroportet mund të përcaktojnë lirshëm kush do t'i ofrojë shërbimet e tyre të lundrimit ajror, duke përfshirë opsionin për t'u vetfurnizuar:
 - aftësia e aeroporteve për të lëvizur drejt vetfurnizimit të shërbimeve të lundrimit ajror,
 - ekzistenca e pengesave ligjore, kontraktuale ose praktike tek aftësia e një aeroporti për të ndryshuar ofruesin e shërbimit të lundrimit ajror,
 - roli i përfaqësuesve të përdoruesve të hapësirës ajrore në procesin e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror.
3. Shtrirja tek e cila ka një rang të ofruesve të shërbimit të lundrimit ajror prej të cilit aeroportet mund të zgjedhin:
 - ekzistencën e ngurtësisë strukturale i cili kufizon zgjedhjen efektive të shërbimit të lundrimit ajror për aeroportet,
 - treguesin e ofruesve alternativë të shërbimit të lundrimit ajror, duke përfshirë opsionin e vetfurnizimit që ofruesit zgjedhin në përzgjedhjen e shërbimit të lundrimit ajror nga aeroportet.
4. Shtrirja tek e cila aeroportet i janë nënshtruar presionit të kostos tregtare ose rregulloret e bazuara tek nxitja:
 - nëse aeroportet plotësojnë aktivisht bizneset e kompanive ajrore,
 - shtrirja tek e cila aeroportet bartin tarifën e shërbimit të lundrimit ajror,
 - nëse aeroportet operojnë në një mjedis konkurrues ose nën nxitje ekonomike të planifikuara për të mbuluar çmimet ose ndryshe për të nxitur uljet e kostos.



SHTOJCA II

TRANSPARENCA E KOSTOS BAZË

1. TABELA E RAPORTIMIT

AAC dhe ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të plotësojnë tabelën e mëposhtme të raportimit për çdo zonë tarifimi nën përgjegjësinë e tyre. Shifrat duhet të jenë aktuale për vitin (n-3) deri në vitin (n-1) dhe shifrat e planifikuara për vitin (n) e tutje. Kostot aktuale duhen përcaktuar në bazë të llogarive të vërtetuara. Ato duhet të caktohen në përputhje me planin e biznesit të kërkuar nga çertifikata referuar në Nenin 7 të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrisë të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian”.

Kostot duhen përcaktuar në monedhën kombëtare.

Tabela 1

Kostot totale

Organizata:

Zona e tarifimit:

Viti n:

(n-3)	(n-2)	(n-1)	(n)	(n+1)	(n+2)	(n+3)	(n+4)	(n+5)
A	A	A	F	F	P	P	P	P

E detajuar sipas natyrës

Stafi								
Kosto të tjera të operimit								
Zhvlerësimi								
Kosto e kapitalit								
Elemente të përjashtuara								
Kostot totale								

E detajuar sipas shërbimeve

Menaxhimi i trafikut ajror								
Komunikimi								
Lundrimi								
Vëzhgimi								
Kërkimi dhe shpëtimi								
Informacioni aeronautik								
Shërbimi meteorologjik								
Kostot e mbikëqyrjes								
Kosto të tjera shtetërore								
Kostot totale								

(n-3)	(n-2)	(n-1)	(n)	(n+1)	(n+2)	(n+3)	(n+4)	(n+5)
A	A	A	F	F	P	P	P	P

Informacion plotësues mbi kursin e këmbimit valutor të monedhës lokale me monedhën evropiane euro

Kursi i këmbimit (1 EUR=)								
---------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--

	(n - 3) A	(n - 2) A	(n - 1) A	(n) F	(n + 1) F	(n + 2) P	(n + 3) P	(n + 4) P	(n + 5) P
Informacion plotësues mbi koston e kapitalit									
Kapitali mesatar i operimit									
Prej të cilit, asetet mesatare afatgjata									
Kosto e kapitalit para tarifës (%)									
Kthim në paanësi (%)									
Interesi mesatar mbi debitet (%)									

2. INFORMACION SHITESË

Për më tepër, AAC dhe ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të japin të paktën informacionin e mëposhtëm:

- përshkrim i metodologjisë së përdorur për shpërndarjen e kostove të mjeteve ose shërbimeve ndërmjet shërbimeve të ndryshme të lundrimit ajror bazuar në listën e mjeteve dhe shërbimeve të paraqitur në Planin Rajonal të ICAO për Lundrimin Ajror, Rajoni Evropian (Dok 7754) dhe një përshkrim i metodologjisë së përdorur për shpërndarjen e atyre kostove ndërmjet zonave të tarifimit,
- përshkrim dhe shpjegim i ndryshimeve midis shifrave të planifikuara dhe atyre aktuale për vitin (n - 1),
- përshkrim dhe shpjegim i kostove të 5-vjeçarit të planifikuar bazuar tek plani i biznesit,
- përshkrim i kostove të shkaktuara nga AAC (Kosto të tjera shtetërore),
- përshkrim dhe shpjegim i metodës së adoptuar për llogaritjen e kostove të zhvlerësimit: kostot historike ose kostot korrente. Kur llogaritja e kostos korrente është adoptuar, parashikon të dhënat e kostos historike,
- justifikim për koston e kapitalit, duke përfshirë komponentët e asetit bazë,
- përshkrim i kostos për çdo aeroport për çdo zonë fundore tarifimi; për aerodromet me më pak se 20000 lëvizje në vit të transportit ajror komercial të llogaritur si mesatarja e 3 viteve të mëparshme, kostot mund të paraqiten si shumë totale për aerodrom,
- ndarja e kostove meteorologjike midis kostove direkte dhe “kostot bazë MET” të përcaktuara si kosto të mbështetjes së pajisjeve dhe shërbimeve meteorologjike që gjithashtu i shërbejnë kërkesave meteorologjike në përgjithësi. Këto përfshijnë analizën e përgjithshme dhe parashikimin, radarin e motit dhe vëzhgimet satelitore, rrjetet tokësore dhe ajrore të vëzhgimit, sistemet e komunikimit meteorologjik, qendrat e përpunimit të të dhënave dhe mbështetjen e kërtimeve bazë, trajnimin e stafit dhe administrimin,
- përshkrim i metodologjisë së përdorur për shpërndarjen e kostove totale MET dhe kostove bazë MET tek aviacioni civil dhe midis zonave të tarifimit.



SHTOJCA II

KËRKESAT SPECIFIKE TË TRANSPARENCËS PËR DISPOZITËN E SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR TEK AEROPORTET QË BIEN NËN NENIN 1(6)

1. KOSTOT E SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR

1.1. Tabela e Raportimit

Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të plotësojnë tabelën e mëposhtme të raportimit për çdo zonë fundore tarifimi nën përgjegjësinë e tyre.

Shifrat duhet të jenë aktuale për vitin (n-3) deri në vitin (n-1) dhe shifrat e planifikuara për vitin (n) e tutje. Kostot aktuale duhen përcaktuar në bazë të llogarive të vërtetuara. Ato duhet të caktohen në përputhje me planin e biznesit të kërkuar nga çertifikata referuar në Nenin 7 të Udhëzimit Nr.6, datë 3.6.2010 të Ministrit të MPPT “Mbi dispozitën e shërbimeve të lundrimit ajror nën Një Qiell të Vetëm Evropian”.

Kostot duhen përcaktuar në monedhën kombëtare.

Tabela 1

Kostot Totale

Organizata:

Zona e tarifimit:

Viti n:

(n-3)	(n-2)	(n-1)	(n)	(n+1)	(n+2)	(n+3)	(n+4)	(n+5)
A	A	A	F	F	P	P	P	P

E detajuar sipas natyrës

Stafi								
Kosto të tjera të operimit								
Zhvlerësimi								
Kosto e kapitalit								
Elemente të përjashtuara								
Kostot totale								

1.2. Informacion shtesë

Për më tepër, AAC dhe ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të japin të paktën informacionin e mëposhtëm:

- përshkrim i metodologjisë së përdorur për shpërndarjen e kostove të mjeteve ose shërbimeve ndërmjet shërbimeve të ndryshme të lundrimit ajror bazuar në listën e mjeteve dhe shërbimeve të paraqitur në Planin Rajonal të ICAO për Lundrimin Ajror, Rajoni Evropian (Dok 7754),
- përshkrim dhe shpjegim i ndryshimeve midis shifrave të planifikuara dhe atyre jo-konfidenciale për vitin (n-1),
- përshkrim dhe shpjegim i kostove jo-konfidenciale dhe investimeve të 5-vjeçarit të planifikuar bazuar tek trafiku i pritshëm,
- përshkrim dhe shpjegim i metodës së adoptuar për llogaritjen e kostove të zhvlerësimit: kostot historike ose kostot korrente,
- shpjegim për koston e kapitalit.

2. FINANCIMI I SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR

Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të japin informacionin e mëposhtëm për çdo zonë fundore tarifimi:

— përshkrimin e mënyrave sipas të cilave janë financuar shërbimet e lundrimit ajror.

SHTOJCA IV

LLOGARITJA E NJËSIVE TË SHËRBIMIT PËR MBIKALIMET

1. Njësia e shërbimit për mbikalimin duhet llogaritur si prodhim i faktorit distancë me faktorin peshë për avionin që mbikalon hapesirën ajrore të Shqipërisë.
2. Faktori distancë duhet përfutur duke pjestuar me 100 numrin e kilometrave të fluturuara në distancën e rrethit të madh midis pikës hyrëse dhe pikës dalje të zonës së tarifimit, sipas planit më të fundit të njohur të fluturimit të skeduar nga avioni me qëllim lëvizjeje trafiku ajror.
3. Nëse pika hyrëse dhe pika dalje të zonës së tarifimit janë identike, faktori distancë do të jetë i barabartë me distancën në distancën e rrethit të madh midis këtyre pikave dhe pikës më të largët të planit të fluturimit.
4. Distanca e marrë në konsideratë duhet të ulet me 20 km për çdo ngritje nga dhe për çdo ulje në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Faktori peshë, i shprehur si një shifër e marrë tek dy rangje dhjetore, do të jetë rrënja katrore e herësit të përfutur nga pjesëtimi me 50 i numrit të tonëve metrik në peshën maksimale të certifikuar të ngritjes së avionit siç tregohet në certifikatën gatishmërisë për fluturim ose në ndonjë dokument zyrtar ekuivalent të lëshuar nga operatori i avionit. Kur kjo peshë është e panjohur, përdoret pesha e avionit më të rëndë të të njëjtit tip të njohur që ekziston. Kur një avion ka disa pesha maksimale të certifikuara ngritjeje, përdoret pesha maksimum. Kur një operator avioni operon dy ose më shumë aviona që janë versione të ndryshme të të njëjtit tip, do të përdoret mesatarja e peshave maksimale të ngritjes për të gjithë avionët e atij tipi. Llogaritja e faktorit peshë për çdo tip avioni dhe për çdo operator duhet të kryhet të paktën 1 herë në vit.

SHTOJCA V

LLOGARITJA E NJËSIVE TË SHËRBIMIT FUNDOR

1. Njësia e shërbimit fundor do të jetë e barabartë me faktorin peshë të avionit.
2. Faktori peshë, i shprehur si një shifër e marrë me dy pozicione dhjetore, do të jetë herësi i përfutur nga pjesëtimi me 50 i numrit të tonëve metrik në peshën më të madhe maksimale të certifikuar të ngritjes së avionit, referuar tek Shtojca IV, paragrafi 5 të kësaj Rregulloreje, në fuqi të 0,7. Sidoqoftë, në një periudhë kalimtare 5 vjeçare që pason llogaritjen e normës së parë të njësive për shërbimin fundor nën këtë Rregullore, ky eksponent do të jetë midis 0,5 dhe 0,9.



SHTOJCA VI

MEKANIZMI I VENDOSJES SË TARIFËS

1. TABELA E RAPORTIMIT

AAC duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme të raportimit për çdo zonë tarifimi nën përgjegjësinë e tij. Ai gjithashtu duhet të japë një Tabelë 1 të konsoliduar për çdo zonë tarifimi nën përgjegjësinë e tij. Kur një zonë tarifimi shtrihet nëpër hapësirën e më shumë se një AAC, ata duhet të plotësojnë bashkarisht tabelën në përputhje me përcaktimet që i referohen Nenit 4(4) të kësaj Rregulloreje.

Shifrat duhet të jenë aktuale që nga viti (n – 3) deri në vitin (n – 1) dhe shifra të planifikuara për vitin (n) e tutje. “Kostot totale” duhen llogaritur si shuma e të gjitha kostove të paraqitura në Tabelën 1, të cilat janë shpërndarë tek kjo zonë tarifimi.

Tabela 2

Llogaritja e tarifës njësi

Organizata:

Zona e tarifimit:

Viti n:

(n – 3)	(n – 2)	(n – 1)	(n)	(n + 1)	(n + 2)	(n + 3)	(n + 4)	(n + 5)
A	A	A	F	F	P	P	P	P

Tarifa njësi (në euro)

Kostot totale (1)								
Kostot e fluturimeve të përjashtuara								
Sasitë e mbetura në vitin(n)								
Të ardhura nga burime të tjera								
Kosto të tatueshme								
Totali i njësive të shërbimit								
Njësi shërbimi të tatueshme								
Tarifa njësi (2)								

(1) Si shumë e gjithë kostove totale të paraqitura në Tabelën 1 të cilat shpërndahen tek kjo zonë tarifimi

(2) Tarifa Njësi – kosto e tatueshme/Njësi e shërbimit të tatueshëm

(n – 3)	(n – 2)	(n – 1)	(n)	(n + 1)	(n + 2)	(n + 3)	(n + 4)	(n + 5)
A	A	A	F	F	P	P	P	P

Tarifa njësi (në monedhën lokale)

Kursi i këmbimit (1 EUR=)								
Tarifa njësi								

	(n - 3) A	(n - 2) A	(n - 1) A	(n) F	(n + 1) F	(n + 2) P	(n + 3) P	(n + 4) P	(n + 5) P
Bilanci i mbetur (në monedhën lokale)									
Tarifat e faturuara për përdoruesit									
Kostot aktuale totale									
Të ardhurat nga burime të tjera									
Kostot aktuale të fluturimeve të përjashtuara									
Sasitë e mbetura në vitin(n)									
Bilanci i vitit (n)									

2. INFORMACION SHITESË

Për më tepër, AAC duhet të grumbullojë dhe ofrojë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- përshkrimin dhe arsyetimin për caktimin e zonave të ndryshme të tarifimit, veçanërisht në lidhje me zonat fundore të tarifimit dhe subvecionet potenciale midisw aeroporteve,
- përshkrimin dhe shpjegimin mbi llogaritjen e njësive të shërbimit të tatueshëm të parashikuar,
- përshkrimin dhe shpjegimin e metodologjisë së përdorur në lidhje me rigjenerimin e bilancit që rezulton nga mbi ose nën mbulimi i viteve të mëparshme,
- përshkrimin e politikës mbi përjashtimet dhe një përshkrim të mjeteve të financimit për të mbuluar kostot përkatëse,
- përshkrimin e të ardhurave nga burime të tjera kur ato ekzistojnë,
- përshkrimin dhe shpjegimin e stimuljeve të aplikuara mbi ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror dhe, në veçanti, modalitetet që aplikohen në vendosjen e kushteve rregullatore, mbi nivelin e normave njësi. Përshkrim dhe shpjegim i objektivave në termat e performancës dhe mbi modalitetet për t'i marrë ato në konsideratë për caktimin e normave maksimale njësi,
- përshkrimin e planeve të ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror për të përmbushur kërkesat e projektuara dhe objektivat e performancës,
- përshkrimin dhe shpjegimin e stimuljeve të aplikuar mbi përdoruesit e shërbimeve të lundrimit ajror.



VENDIM
Nr. 41, datë 29.4.2013

**MBI TRANSFERIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË
“HEC ULËZ-SHKOPET” SHA, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS TE “KURUM INTERNATIONAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 94/2013, datë 4.3.2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë HEC Ulëz-Shkopet, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë Kurum International”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 9.1.2013 “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a.”, pikës 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 41, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe aplikimit të shoqërisë HEC Ulëz-Shkopet, për transferimin e kontrollit të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” nga METE te “Kurum International” sh.a. dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te “Kurum International” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 42, datë 29.4.2013

**MBI TRANSFERIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË
“HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2” SHA, NGA MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TE “KURUM INTERNATIONAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 93/2013, datë 4.3.2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 % të aksioneve të shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 9.1.2013 “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, pikës 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe aplikimit të shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, për transferimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. nga METE te “Kurum International” sh.a. dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aksionarit që kontrollojnë interesin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te “Kurum International” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 43, datë 30.4.2013

**MBI NDRYSHIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT TË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E ENERGJISË SË
RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “m” iv, nenit 9 dhe të nenit 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

- Në rregullat dhe procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, bëhet një ndryshim dhe një shtesë në paragrafin e dytë, neni 7 të tij:

“Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet për një central prodhues, të vënë në operim për herë të parë paralel me rrjetin elektrik pas 2.11.2000.

Mund të kualifikohen si burime të rinovueshme energjie dhe hecet me fuqi të instaluar nën 10 MW, të vëna në punë jo më pak se 15 vjet më parë dhe që janë objekt i fuqizimit dhe i ripunimit total pasi të verifikohen në vend këto punime.

Mund të kualifikohen si burime të rinovueshme energjie dhe hecet me fuqi të instaluar të barabartë, apo mbi 10 MW, të vëna në punë jo më pak se 30 vjet më parë dhe që janë objekt i fuqizimit dhe i ripunimit total pasi të verifikohen në vend këto punime.

Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet, gjithashtu, për një central prodhues energjie të rinovueshme dhe në fazën e projektimit ose në fazën e ndërtimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 24.5.2013
Doli nga shtypi më 24.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë